

KOMITETI DREJTUES

Tiranë, 26 qershor 2023

Nr. 52 Prot.

Vendim Nr.4 i KD-së

Kryesia e FSHB-së në mbledhjen e sajë më datë 23 qershor 2023, drejtuar nga Presidenti i FSHB-së, Z. Avni Ponari dhe prezencë të anëtarëve, Znj. Migena Plasa, Z. Juel Jarani dhe Z. Klevis Kaso, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. Organizimi i ekipeve kombëtare qershor-gusht 2023;
 - Ekipi Kombëtar Meshkuj;
 - Moshat: U20/18/16 Djem dhe U18/16 Vajza.
2. Kontratat me trajnerët e ekipeve kombëtare të moshave dhe mbështetësit.
3. Pjesëmarrja me ekipin kombëtar femra të rritura në eliminatoret e FIBA EuroBasket femra 2025;
4. Dokumentacionet për rifillimin e kampionateve kombëtare të edicionit sportiv 2023-24;
 - Rregullore e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit;
 - Rishikimi i numrit të skuadrave pjesëmarrëse në Superligën Meshkuj;
 - Rishikim i tarifave të pjesëmarrjes në Superligën Meshkuj dhe Kategorinë I-rë Femra;
 - Promovimi i lojtarëve shqiptarë;
 - Dokumentacionet për pjesëmarrjen e shoqatave në edicionin sportiv 2023-24;

Për sa më sipër KD-ja vendosi:

1. Miratimin e grumbullimeve të ekipeve kombëtare në funksion të pjesëmarrjeve në turnetë ndërkombëtar organizuar nga FIBA në periudhën korrik-gusht 2023:

| Ekipi | Përfaqësimi |
|-------------------|---|
| Meshkuj të rritur | Ndeshjet para-eliminatore për FIBA Eurobasket 2025: Shqipëri vs. Rumani: 19.07.2023 Sllovaki vs. Shqipëri: 26.07.2023 Rumani vs. Shqipëri: 29.07.2023 Shqipëri vs. Sllovaki: 05.08.2023 |
| U20 Djem | Kampionati European U20 djem, Div.B, Maqedoni e Veriut, 7-16 Korrik 2023. |

| | |
|-----------|---|
| U18 Djem | Kampionati European U18 djem, Div.B, Portugali, 21-30 korrik 2023. |
| U18 Vajza | *Organizuar në Shqipëri - Kampionati European U18 vajza, Div.C, Durrës, 1-6 gusht 2023. |
| U16 Djem | Kampionati European U16 djem, Div.C, Kosovë, 19-27 korrik 2023. |
| U16 Vajza | Kampionati European U16 vajza, Div.C, Andorra, 18-23 korrik 2023. |

2. Lidhja e marrëveshjeve kontraktuale me trajnerët e parë të ekipeve kombëtare mbështetur në Nenin 25, pika "11" të Statutit të FSHB-së, si dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave, nr. 1268 prot, datë 25.02.2022, pika 9/b, Presidenti i FSHB-së, në ushtrim të kompetencave të tij, për zgjedhjen dhe kontraktimin e trajnerëve të ekipeve kombëtare të basketbollit;
3. Ekipi kombëtar femra nuk do të marrë pjesë në eliminatoret e EuroBasket 2025. Të shikohet mundësia për aktivizim në aktivitete të tjera të FIBA-s në nivel më të përshtatshëm për këtë kategori.
4. Komiteti Drejtues pas diskutimeve të tejzgjatura, duke analizuar dhe nevojën e promovimit të lojtarëve vendas, vendosi miratim të Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit me ndryshime të cilat do të zbatohen në veprimtaritë e FSHB-së.
5. Miratoi dokumentat për fillimin e edicionit të ri sportiv për shoqatat që do të marrin pjesë në aktivitetet 2023-24.
6. Ky vendim hyn në fuqi për edicionin sportiv 2023-24.